

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Menaxherial dhe i
Kostos

P2

Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'JU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT

Do Not Open Until Your Invigilator Allows You to Do So.

2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA
PYETJEVE

All Questions Are Mandatory

3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË

Time Allowed is 3 Hours

4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË
FLETË TË KËTIJ PROVIMI.

Your name should appear nowhere in this test.

Data **30.09.2023**

PROBLEMI 1

a) ABC L.L.C. prodhon vaksinën Omicron për trajtimin e COVID 19. Procesi i prodhimit përdor dy lëndë të para (M & W) të cilat janë të përziera në përmasa (2:3). Çmimet e materialeve janë: M = 10 € për kg dhe W = 3.2 € për kg. Humbja normale e peshës prej 5% të inputit material është e pritshme gjatë procesit dhe humbjet materiale të regjistruara në procesin e prodhimit nuk kanë vlerë të shitjes. Në fund të prodhimit, 18,260 kg vaksinë Omicron u prodhuan nga 19,320 kg lëndë të parë. Kostot e konvertimit në periudhë ishin 57,316€. Nuk kishte punë në proces në fillim apo në fund të periudhës.

Kërkohet:

Përgatitni llogarinë e procesit të vaksinës Omicron për periudhën.

(10 pikë)

b) XIX L.L.C. shiti 150,000 njësi të produktit të saj me 20 € për njësi. Kostot variabile janë 15 € për njësi (kosto e prodhimit 12 € dhe shpenzimet e shitjes 3 €). Kostot fikse shkaktohen në mënyrë të njëtrajtshme gjatë gjithë vitit dhe arrijnë në 972,000€ (pra kostot e prodhimit prej 600,000€ dhe shpenzimet e shitjes prej 372,000€).

Kërkohet:

i) Llogaritni pikën kritike (pragun e rentabilitetit) në njësi dhe euro. (4 pikë)

ii) Llogaritni numrin e njësive që duhet të shiten për të fituar €75,000 para tatimit (2 pikë)

iii) Llogaritni numrin e njësive që duhet të shiten për të fituar një fitim pas tatimit prej 100,000 € nëse norma e tatimit mbi fitimin është 40% (4 pikë)

(Totali: 20 pikë)

PROBLEMI 1 - ZGJIDHJA

a) Llogaritja e njësive ekuivalente		kg
Outputi	18,260	18,260
Humja normale (5% x19,320kg)	966	-
Humbja jo-normale	94	+94
Hyrja	19,320	18,354*

*18,354kg përfaqëson njësitet ekuivalente

Kosto e procesit	(€)	
Kosto e MD		
M (2/5 x 19,320 x €10)		77,280
W (3/5 x 19,320 x €3.2)		37,094
Kosto e konvertimit	57,316	
Vlera mbetur (8 x €5)		-
Kosto totale e procesit	<u>171,690</u>	

Kosto për njësi = €171,690/18,354*kg
= €9.35 për kg

Llogaria (konti) e procesit

		Process A/ c			
Hyrjet	Kg	Kosto		Kg	Kosto
		(€)			(€)
M €10	7,728	77,280	Dalja	18,260	170,731
W €3.2	11,592	37,094	Humbja N.	966	0.00
Kosto e konvert.	-	57,316	Humbja JN.	94	878.9
	<u>19,320</u>	<u>171,690</u>		<u>19,320</u>	<u>171,609</u>

b)

i) Pika rentabël

$$\begin{aligned} \text{(Njësi)} &= \frac{\text{KF}}{\text{Cmimi shitjes - KV (njësi)}} \\ &= \frac{€972,000}{(€20 - €15)} \\ &= \mathbf{194,400 \text{ njësi}} \\ \\ \text{(Euro)} &= \frac{\text{Kosto Fikse}}{\text{Marzha e kontributit (marzha)}} \\ &= \frac{€972,000}{(€(20 - 15)/20)} \\ &= \mathbf{€3,888,000} \end{aligned}$$

ii) Njësitë e kërkuara për të realizuar një fitim prej €75,000

$$\begin{aligned} &= \frac{\text{KF + fitimi}}{\text{Cmimi - KV (njësi)}} \\ &= \frac{€(972,000 + 75,000)}{€(20 - 15)} \\ &= \mathbf{209,400 \text{ njësi}} \end{aligned}$$

iii) Njësitë e kërkuara për të realizuar një fitim prej 100,000€ pas tatimit

$$\begin{aligned} &= \frac{\text{KF + Fitimi}}{\text{Cmimi - KV (njësi)}} \\ &= \frac{\frac{€972,000 + (\frac{100,000}{1-0.4}}{5}}{€(20 - 15)} \\ &= \frac{€972,000 + 166,667}{5} \\ &= \mathbf{227,733 \text{ njësi}} \end{aligned}$$

PROBLEMI 2

a) ABC L.L.C. prodhon një produkt – “teleskopin”. Rezultatet aktuale për periudhën ishin:

Prodhimi: 430 njësi të prodhuara
Materialet: 1075 kg janë përdorur.
Janë blerë 1,200 kg materiale me një kosto prej 17,700 €
Puna direkte: janë punuar 1,700 orë me kosto 14,637 €
SHPP variabile e prodhimit: 3,870 €.

Karta standarde e kostos për produktin është si më poshtë:

Materiali direkt 2 kg x 15 = 30 €
Puna direkte 4 orë x 8,50 € = 34
SHPP Variabile 4 orë x 2,00 = € 8

Karta e kostos bazohet në prodhimin dhe shitjet e 450 njësive në çdo periudhë. Kompania vlerëson inventarët e saj me kosto standarde.

Kërkohet:

Llogaritni variancat e mëposhtme:

- i) Varianca e çmimit të materialit.**
- ii) Varianca e përdorimit të materialit.**
- iii) Varianca e normës së punës.**
- iv) Varianca e efikasitetit të punës.**
- v) Varianca e SHPP variabile.**

(15 pikë)

b) Qëllimi i Kontabilitetit të Menaxhimit është të sigurojë informacion për planifikim, kontroll dhe vendimmarrje. Informacioni për kontrollin e performancës është një detyrë e rëndësishme e menaxhimit.

Kërkohet:

Përshkruani TRE (3) aktivitete të përfshira në sigurimin e informacionit për qëllime kontrolli.

(5 pikë)

(Totali: 20 pikë)

PROBLEMI 2 - Zgjidhjet

a)

i) Varianca e cmimit MD

€

1,200 kg duhet të kenë një kosto prej (€15) 18,000

Kosto aktuale 17,700

Varianca e cmimit të MD 300 (F)

ii) Varianca e përdorimit të MD

kg

430 njësi duhet të shfrytëzojnë (2) 860

Shfrytëzuan 1,075

Varianca e vëllimit në KG 215 (A)

Cmimi standard për KG €15

Varianca e vëllimit-përdorimit të MD (€) 3,225 (PF)

iii) Varianca e normës së pagesës së PD

€

1,700 orë duhet të kenë një kosto prej (€8.50) 14,450

Kosto aktuale 14,637

Varianca e normës së pagesës 187 (PF)

iv) Varianca e efikasitetit të PD

orët

430 nësi duhet të kishin marrur (4) 1,720

Koha aktuale 1,700

Varianca e efikasitetit (hours) 20 (F)

Norma standarde e pagesës (€) 8.50

Varianca e efikasitetit të PD (€) 170 (F)

v) Varianca e cmimit të SHPP Variabile

€

1,700 orë duhet të kenë kushtuar (€2) 3,400

Kosto aktuale 3,870

Varianca e cmimit të SHPP V 470 (PF)

b)

Aktivitetet e përfshira në sigurimin e informacionit për qëllime kontrolli përfshijnë si më poshtë:

- Monitorimi i performancës aktuale dhe krahasimi i performancës aktuale me objektivin ose planin
- Vlerësimi i performancës aktuale dhe
- Marrja e veprimeve të kontrollit aty ku është e përshtatshme

PROBLEMI 3

a) Deklarata e mëposhtme tregon përmbledhjen e shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit që janë ndarë në katër departamentet që operojnë në ABC Ltd me informacion shtesë.

Departmenti	1	2	3	4
SHPP totale (€)	45,000	35,000	20,000	40,000
Orët e punës	1,200	1,000	800	1,500
Njësitë e prodhuara	8,000	6,000	4,000	7,000
Orët e makinerive	2,500	3,000	1,800	4,000
Kosto primare (direkte) për njësi (€)	42	25	30	34

Kërkohe:

- i) Llogaritni TRI (3) norma të absorbimit të SHPP-së në nivel të fabrikës. (6 pikë)
- ii) Llogaritni DY (2) norma të absorbimit të SHPP-së për departamentin 1. (3 pikë)
- b) Shpjegoni nën dhe mbi absorbimin e SHPP-së. (3 pikë)
- c) Tregoni efektin e mbi absorbimit të SHPP në fitimin e raportuar. (3 pikë)
- d) Tregoni KATËR (4) supozime në bazë të analizës kost-vëllim-fitim (KVF/CVP). (5 pikë)

(Totali: 20 pikë)

PROBLEMI 3 - Zgjidhjet

a)

i) Llogaritjet e normave të absorbimit të SHPP-së:

SHPP totale	€140,000	Orët totale	4,500
Njësitë e prodhuara	25,000		
Orët totale makinerie		11,300	Kostot
primare	€844,000		

Koeficienti	
Orët e punës	$€140,000 \div 4,500 = €31.1$ për orë PD
Njësitë e prodhuara	$€140,000 \div 25,000 = €5.6$ për njësi
Orët e makinës	$€140,000 \div 11,300 = €12.39$ për orë makine
Kostot primare	$€140,000 \div €844,000 = 0.17$ orë ose 17% e kostove primare

ii) Koeficientët për departamentin 1

OAR	
Orët e punës	$€45,000 \div 1200 = €37.5$ për orë PD
Njësitë e prodhuara	$€45,000 \div 8000 = €5.625$ për njësi
Orët e makinës	$€45,000 \div 2,500 = €18$ për orë makine
Kostot primare	$€45,000 \div €336,000 = 0.134$ ose 13.4%

b)

Nën absorbimi i SHPP ndodh kur shpenzimet e përgjithshme të ngarkuara (absorbuara) për punën aktuale janë më të vogla se shpenzimet e përgjithshme aktuale.

Mbi absorbimi i SHPP ndodhi kur shpenzimet e përgjithshme të ngarkuara për punën aktuale janë më shumë se shpenzimet e përgjithshme të shkaktuara.

c)

Efekti i shpenzimeve të përgjithshme të përthithura në fitim është se, meqenëse kostoja e përgjithshme e ngarkuar do të ishte mbivlerësuar, kostoja e mallrave të shitura do të **mbivlerësohej duke ulur kështu fitimin.**

d) Supozimi në analizën CVP

- Kostot janë ose fikse ose të ndryshueshme (variabile). Kostoja variable për njësi është e njëjtë në të gjitha nivelet e aktivitetit (Output dhe shitje). Kostoja totale fikse është një shumë konstante në çdo periudhë.
- Kostot fikse normalisht supozohen të mbeten të pandryshuara në të gjitha nivelet e prodhimit.
- Kontributi për njësi është konstant për çdo njësi të shitur (të të njëjtit produkt).
- Çmimi i shitjes për njësi është konstant për çdo njësi të produktit të shitur; prandaj edhe raporti i kontributit për shitje është një vlerë konstante në të gjitha nivelet e shitjeve.
- Nëse shitjet për njësi, kosto variable për njësi dhe kostot fikse nuk ndikohen nga vëllimi i aktivitetit, shitjet dhe fitimet maksimizohen duke maksimizuar kontributin total.

PROBLEMI 4

ABC SH.P.K. prodhon dhe shet një produkt të vetëm. Kompania operon një sistem standard të kostos marxhinale dhe një sistem blerjeje dhe prodhimi në kohë. Nuk mbahet asnjë inventar i lëndëve të para ose produkteve të gatshme.

Detajet e buxhetit dhe të dhënat aktuale për periudhën janë si më poshtë:

Të dhënat e buxhetara:

Kostoja standarde e prodhimit për njësi:

€

Materiali direkt: 8 kg @ 10,80 € për kg €86.40

Puna direkte: 1.25 orë @ 18.00 € në orë €22.50

SHPP variabile: 1,25 orë @ 6,00 € për orë PD €7.50

Çmimi standard i shitjes: 180 € për njësi

SHPP fikse e buxhetuar: 170,000 €

Prodhimi dhe shitjet e buxhetuara: 10,000 njësi

Të dhënat aktuale:

Materiali direkt: 74,000 kg @ 11,20 € për kg

Puna direkte: 10,800 orë @ 19,00 € në orë

SHPP variabile: 70,000 €

Çmimi aktual i shitjes: 184 € për njësi

Shpenzimet aktuale fikse të prodhimit: 168,000 €

Prodhimi dhe shitjet aktuale: 9,000 njësi

Kërkohet:

Duke përdorur parimet e kostos marxhinale, përgatitni një raport që rakordon (harmonizon) kontributin e buxhetuar dhe kontributin aktual. (Raporti juaj duhet të tregojë ndryshimet në sa më shumë detaje që të jetë e mundur).

(Total: 20 pikë)

PROBLEMI 4 - ZGJIDHJA

Kontributi aktual

		€
Shitjet (9000 x 184)		1,656,000
Minus:		
MD (74000 x 11.20)	828,800	
PD (10800 x 19)	205,200	
SHPP Variable	70,000	(1,104,000)
		<u>552,000</u>

VARIANCAT

Varianca e cmimit të shitjes	(Kontributi standard – Kontributi aktual) Sasia aktuale e shitur (63.6 – 67.6)9000 = €36,000 F
Varianca e vëllimit të shitjes	(Sasia e buxhetuar – Sasia aktuale) Kontributi standard (10,000 – 9,000) 63.6 = €63,600 PF
Varianca e cmimit të MD	(Cmimi standard – Cmimi aktual) Sasia aktuale (10.80 – 11.20) 74,000 = €29,600 PF
Varianca e përdorimit të MD	(Sasia standarde – Sasia aktuale) Cmimi standard (72,000 – 74,000) 10.80 = €21,600 PF
Varianca e normës së pagesës së PD	(Norma standarde – Norma aktuale) Orët aktuale (18 – 19) 10,800 = €10,800 PF
Varianca e efikasitetit të PD	(Orët standarde – Orët aktuale) Norma standarde (11,250 – 10,800) 18 = €8,100 F
Varianca e shpenzimit të SHPP-v	(Norma standarde x Orët aktuale – SHPP aktuale) (64,800 – 70,000) = €5,200 PF
Varianca e efikasitetit të SHPP-v	(Orët standarde – Orët aktuale) Norma standarde (11,250 – 10,800) 6 = €2,700 F

Një pasqyrë/raport që barazon kontributin e buxhetuar dhe kontributin aktual

	€	€	€
Kontributi i buxhetuar			636,000
Varianca e volumit të shitjeve (9,000 njësi - 10,000 njësi) x €63.60			63,600 PF
Varianca e cmimit të shitjes 9,000 njësi x (€184 - €180)			36,000 F

			608,400
Varianca te kostove	F	A	
Varianca e cmimit të MD 74,000 kg x (€10.80 - €11.20)		29,600	
Varianca e përdorimit të MD (9,000 x 8 kg) - 74,000 kg) x €10.80		21,600	
Varianca e normës (cmimit) të PD 10,800 x (€18.00 - €19.00)		10,800	
Varianca e efikasitetit të PD (9,000 x 1.25) - 10,800) x €18.00	8,100		
Varianca e shpenzimit të SHPP - v (10,800 orë x €6) - €70,000		5,200	
Varianca e efikasitetit të SHPP - v (9,000 x 1.25) - 10,800) x €6.00	2,700		
	10,800	67,200	56,400 A
Kontributi aktual			552,000

Fitimi i buxhetuar

	€
Kontributi I buxhetuar	636,000
Kostot fikse të buxhetuara	<u>(170,000)</u>
	<u>466,000</u>

Varianca e vëllimit të shitjeve	(Sasia e buxhetuar - Sasia aktuale) Profiti standard
	(10,000 - 9,000) 46.6 = 46,600 PF
Varianca e shpenzimit të SHPP - fikse	(SHPP fikse e buxhetuar - SHPP fikse aktuale)
	(170,000 - 168,000) = €2000 F
Varianca e volumit të SHPP - fikse	(SHPP fikse e prodhimit aktual - SHPP fikse e buxhetuar)
	(17 x 9,000 - 170,000) = €17,000 PF

Shënim: **Fitimi standard/njësi**

		€
Cmimi i shitjes		180
Kosto standarde	116.4	
SHPP fikse	17	(133.4)
		46.6

PROBLEMI 5

Ju jeni Kontabilist i Kostos për ABC Ltd, të cilit i është kërkuar të dërgojë një kuotim (cmim/ofertë) për prodhimin e një programi për panairin lokal të fshatit. Puna do të kryhej krahas punës normale të kompanisë. Për shkak të angazhimeve ekzistuese, punonjësve do t'u kërkohej të punojnë gjatë fundjavave për të përfunduar printimin e programit.

Një kontabilist praktikant ka prodhuar vlerësimin e mëposhtëm të kostos bazuar në burimet e kërkuara siç specifikohet nga menaxheri i prodhimit:

Materiale direkte – Letër (vlera kontabël)	€5,000
– Ngjyrat (çmimi i blerjes)	€2,400
Puna direkte – Të kualifikuar 250 orë @ 4,00	€1,000
– Të pakualifikuar 100 orë @ 3,50	€ 350
SHPP variabile 350 orë @ 4,00	€1,400
Zhvlerësimi i shtypshkronjës 200 orë @ 2,50	€500
Kostoja fikse e prodhimit 350 orë @ 6,00	€2,100
Kosto e departamentit të vlerësimit	€400
Gjithsej	€13,150

Ju jeni të vetëdijshëm se mund të arrihet një publicitet i konsiderueshëm për kompaninë nëse jeni në gjendje të fitoni këtë porosi dhe çmimi i kuotuar duhet të jetë shumë konkurrues.

Shënimet e mëposhtme janë të rëndësishme për vlerësimin e kostos relevante (përkatëse):

i) Letra që do të përdoret është aktualisht në depo në vlerë prej €5,000. Eshte me ngjyre te pazakonte dhe ka kohe që nuk është përdorur. Çmimi i zëvendësimit të letrës është €8,000, ndërsa vlera e skrapit/firos të asaj që është në magazinë është €2,500. Menaxheri i prodhimit nuk parashikon ndonjë përdorim alternativ për letrën nëse nuk përdoret për programin e panairit të fshatit.

ii) Ngjyrat e kërkuara nuk mbahen në depo. Ato do të duhej të bliheshin me shumicë me një kosto prej €3,000. Megjithatë, vetëm 80% e bojës së blerë do të përdoret në printimin e programit. Asnjë përdorim tjetër nuk parashikohet për pjesën e mbetur.

iii) Puna direkte e kualifikuar është aktualisht me kapacitet të plotë, por mund të punësohet punë shtesë. Për të akomoduar printimin e programeve, 50% e kohës së kërkuar do të punohej në fundjavë, për të cilat paguhet një prim (pagë shtesë) prej 25% mbi tarifën normale për orë. Tarifa normale për orë është 4€ në orë.

iv) Puna e pakualifikuar aktualisht është e pashfrytëzuar dhe aktualisht 200 orë në javë regjistrohen si kohë boshe. Nëse puna e printimit kryhet në fundjavë, në këtë kohë do të duheshin 25 orë punë të pakualifikuara, por punonjësve në fjalë do t'u jepeshin dy orë

pushim (për të cilat do të paguhen) për çdo ore të punës të punuar.

v) SHPP variable përfaqëson koston e funksionimit të shtypshkronjës dhe makinerive lidhëse.

vi) Kur nuk përdoret nga kompania, shtypshkronja/ shtypi merret me qira në kompani të jashtme për 6 € në orë. Kjo fiton një kontribut prej 3€ në orë. Ka kërkesa të pakufizuara për këtë objekt.

vii) Kostot fikse të prodhimit janë ato të shkaktuara dhe të absorbuara në prodhim, duke përdorur një normë (koeficient) për orë bazuar në aktivitetin e buxhetuar.

viii) Kostoja e departamentit të vlerësimit përfaqëson kohën që është bërë tashmë gjatë diskutimeve me komitetin e panairit të fshatit në lidhje me shtypjen e programit të tij.

Kërkohet:

a) Përgatitni një vlerësim të rishikuar të koston duke përdorur një qasje të rrjedhjes relevante (përkatëse) të parasë, duke treguar qartë çmimin minimal që kompania duhet të pranojë për porosinë. Jepni arsyet për çdo vlerësim të burimit në vlerësimin tuaj të koston. (17 pikë)

b) Diskutoni shkurtimisht deklaratën “kostot fikse nuk janë kurrë të rëndësishme për skenarët e vendimmarrjes”. (3 pikë)

(Total: 20 pikë)

PROBLEMI 5 - ZGJIDHJA

a)	Cmimi minimal i porosisë		
	Shënimi	Kosto relevante	€
1		Letra	2,500
2		Ngjyra	3,000
3		PD e kualifikuar	1,125
4		PD e pakualifikuar	-
5		SHPP variable	1,400
6		Shtypi	600
7		Kostot fikse të prodhimit	-
8		Kostot e vlerësimit	-
	Cmimi minimal		<u>8,625</u>

Shënim:

1. Vlera kontabël është e parëndësishme sepse është një kosto e zhytur/fundosur; pasi nuk ka përdorim tjetër, zëvendësimi nuk do të ndodh kështu që kostoja oportune ose të ardhurat nga shitja e skrapit janë vlera përkatëse.

2. Meqenëse kjo përfshin një kosto të ardhshme nëse puna ndërmerret, duhet të përdoret çmimi i blerjes. Meqenëse stoku i mbetur nuk ka përdorim të parashikueshëm, ai nuk ka vlerë, kështu që përdoret e gjithë kostoja e blerjes.

3. Meqenëse fuqia punëtore e kualifikuar do të funksiononte gjatë fundjavave, kostoja e plotë është e rëndësishme; $125 \text{ orë} @ 4 \text{ €/orë} = 500 \text{ €}$
 $125 \text{ orë} @ 5 \text{ €/orë} = 625 \text{ €}$

4. Puna e fundjavës rezulton me 50 orë pushim në vend të kësaj, me 75 orët e tjera të punuara, është gjithsej 125 orë, që është më pak se 200 orë boshe që tashmë paguhet; kështu që nuk ka kosto shtesë.

5. Kjo është një kosto e ardhshme që do të shkaktohet nëse puna ndërmerret.

6. Amortizimi është një kosto e kaluar dhe duhet të injorohet, megjithatë përdorimi i shtypit ka një kosto oportune. Nëse kjo punë ndërmerret, shtypi nuk mund të merret me qira. Kostoja oportune është kontributi që do të fitohej nga punësimi: $200 \text{ orë} @ (6-3 \text{ €})$.

7. Meqenëse këto kosto nuk ndikohen nga vendimi, ato duhet të injorohen

8. Këto kosto janë kosto të kaluara ose të zhytura dhe duhet të injorohen.

b) Në përgjithësi, klasifikimi i kostove si fikse ose variabile identifikon ato kosto që ndryshojnë në total kur aktiviteti ndryshon (kostot variabile) dhe ato totali i të cilave mbetet konstant (kosto fikse).

Kostot përkatëse janë ato që ndikohen nga një vendim, dhe meqenëse shumica e vendimeve ndikojnë në nivelet e aktivitetit, kostot variabile (të cilat ndryshojnë kur aktiviteti ndryshon) mund të shihen si kosto përkatëse.

Megjithatë, nuk rrjedh automatikisht se kostot fikse nuk janë relevante. Disa kosto fikse mund të jenë specifike për produktin ose departamentin dhe për këtë arsye mund të shmangen. Për shembull, një vendim për të ndërprerë një produkt do të bëjë që kostoja specifike e produktit të kursehet.

Nocioni i përgjithshëm që kostot fikse nuk janë relevante është i pasaktë prandaj çdo vendim duhet të konsiderohet individualisht. Do të kishte rrethana kur kostoja fikse duhet të konsiderohet e rëndësishme, për shkak të shmangshmërisë së tyre.